



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Zyra e Komisionerit

Nr. 39 Prot

Tiranë, më 18/01/2012

**Lenda :** Dërgohet regjistri mbi realizimin e prokurimeve publike për vitin 2011

**Drejtuar :** Agjencisë së Prokurimit Publik

**TIRANE**

Në mbështetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, V.K.M. nr.1 datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit ", i ndryshuar, Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ", Ligjit nr.10355, date 02.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", i ndryshuar, Udhëzimit nr.4 datë 27.01.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011", ju paraqesim sipas formatit të caktuar të Agjencisë së Prokurimit Publik si dhe në mënyrë elektronike, informacionin e detajuar të realizimit të prokurimeve publike për vitin 2011.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin:

**KOMISIONERI**

Konc:L.Xhaka

Sigloi:L.Morina

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

Rr "Abdi Toptani", Kati i II-të, Nr.4, Tiranë, Tel: + 355 42 237 200

Web-site: [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al), Fax: +355 4 2233977

**Lenda: Mbi Performancën Financiare Buxhetore të KMDP-se dhe realizimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2011.**

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatimin të buxhetit të vitit 2011, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektesë në zbatim të Ligjit nr.10355 datë 02/12/2010 "Për buxhetin e vitit 2011", i ndryshuar, dhe i rishikuar, udhëzimit nr.4 datë 27/01/2011, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011",

Ne mbështetje të Ligjit nr. 10355 datë 02/12/2010 "Për buxhetin e vitit 2011", për vitin 2011, është miratuar për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave personale « programi » buxhetor :

- Programi me emërtimin « Planifikim, menaxhim dhe administrim » ku përfshihet i gjithë buxheti i akorduar për funksionimin e aktivitetit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

#### **Programi "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim"**

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP) së hartuar gjatë procesit të PBA 2011-2014. Ky buxhet është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP: Mbështetja, organizimi, krijimi i kushteve të nevojshme për mirëfunksionimin e KMDP, përafrimin e harmonizimi legjislativ në fushën e të dhënave personale me legjislativin e vendeve të tjera të komunitetit evropian, me të drejtën komunitare si dhe privatesinë, imponimi i legjislativit të sotëm ekzistues vendas si dhe ndergjegjësimin dhe shtrirjen e fushës së zbatimit të ligjit në të gjithë vendin duke garantuar një transparencë totale të përpunimit dhe garantimit të të dhënave, siguri maksimale të të dhënave personale, intensifikimi i marrëveshjeve me strukturat e BE duke garantuar maksimalisht mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve në lëvizje ose rezident në BE. administrimi e menaxhimi i regjistrit elektronik dhe fizik të subjekteve kontrollues, monitorimin, rekomandimin dhe investigimet në kuadrin e mbrojtjes së të dhënave personale, mbi të cilat KMDP zhvillon përgjegjësitë e saj ligjore, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave personale , në mbështetje të ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” , me ndryshimet, V.K.M nr..1,datë 10.01.2007,”Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”,ndryshuar si dhe në baze dhe për zbatim të regjstrit të parashikimeve të vitit 2011, për periudhen janar-dhjetor 2011 ka prokuruar

***I- Fondi per shpenzim investime (zeri 231) , nga vlera e pergjithshme prej 4,000 (ne mije leke) per periudhen e raportuar, eshte prokuruar dhe realizuar ne masen 3.950.096 ne mije leke ose 98.7 % e fondit te planifikuar vjetor.***

Gjate vitit 2011, nje nga detyrat parësore dhe prioritare ka qenë ndjekja e realizimit të procedurave të prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”,i ndryshuar, udhëzimit nr.2 ”Për procedurën e blerjeve të vogla”,mbi bazën e kërkesave dhe fondeve të alokuara sipas projekteve të miratuara për investime e konkretisht jane realizuar investimet e mëposhtme.

- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Blerje e pajisjeve kompjuterike”,per plotësimin e kushteve optimale ne realizimin ne kohe e cilësi të detyrave .Fondi i alokuar nga Ministria e Financave ka qene në masën 480 ne mije leke dhe realizuar me proceduren me blerje te vogel ne masen 479 .120 (leke ).
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Blerja dhe instalimi e centralit të brendshëm telefonik” i cili mundësoi komunikimin e brendshëm dhe te jashtem nepermjet pritjes dhe transferimit automatik te thirrjeve si dhe monitorimin në menyre të detajuar të telefonatave në kohë dhe impulse ,me anë të së ciles u krijua mundesia e përdorimit me efektivitet te shpenzimeve telefonike drejt minimizimit të shpenzimeve konkrete.Fondi i alokuar nga Ministria e Financave ne Projektin M890010(480 ne mije leke eshte realizuar me proceduren blerje e vogel, prane Firmes Global Net ne shumen 470 (ne mije leke) .
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Ndertimi i rrjetit te brendshme kompjuterik” i cili do te mundesoje lidhjen e te gjithë përdoruesve me serverin qendror. Fondi i alokuar nga Ministria e Financave ne Projektin M890010(222 ne mije leke) eshte realizuar me proceduren blerje e vogel, prane Firmes MC Networking ne shumen 221 (ne mije leke) .
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Blerje pajisje kondicionuese”per zyrat per krijimin e kushteve optimale te punonjësve . Fondi i flokuar nga Ministria e Financave ka qene ne masen 320 ne mije leke, dhe eshte realizuar ne shumen 319 ne mije leke me proceduren Blerje e Vogel prane Firmes Uni Klima.

- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Pajisja e dhomës së serverit” me bazën materiale dhe pajisjet me të domosdoshme për krijimin e kushteve optimale të sigurisë së dhenave që do të përmbajene shumen 46 në mijë leke ,realizuar me procedurën me blerje të vogël.
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Sistem akses kontrolli me kartë hyrëse-dalese” i cili mundësoi forcimin dhe disiplinimit të zbatimit të orarit të punës për punonjësit e Zyres së KMDP, rritjes dhe forcimit të masave të sigurisë për hyrjen e personave të paautorizuar në ambientet e brendshme të stafit si dhe forcimin dhe vendosjes së masave të sigurisë në ambientet e dhomës së servareve , ku menaxhohet dhe ruhet dokumentacioni i prodhuar i zyrës së KMDP .Fondi i akorduar dhe parashikuar nga institucioni ka qenë në masën 400 në mijë leke dhe u realizua me procedurën me blerje të vogël 396.623 leke pranë firmës AESS .
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurës me objekt prokurimi “Intranet” alokuar nga Ministria e Financave në vlerën 1.000 (në mijë leke) Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit” pasi janë ndjekur procedurat e tenderimit me procedurën “Kerkese me propozim ” e pas deshtimit të tyre dy herë radhazi për mungesë konkurrence është ndjekur procedura e mesipërme Fondi i venë në dispozicion ka qenë 1.000 në mijë leke dhe është negociuar dhe fituar nga Firma fituese MC Networking në shumen 984 në mijë leke me TVSH, sipas kontratës së lidhur me datën 19.07.2011 me kohezagjatje prej një periudhe 5-mujore.
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurës me objekt “Orendi-mobilje Zyre “ Fond i alokuar nga Ministria e Financave nën projektin M89001 ka qenë në shumen 480 në mijë leke dhe është realizuar me procedurën Blerje të vogël , në shumen 479 në mijë leke pranë firmës Aulivia
- Ndjekja dhe vijimi i procedurës me blerje të vogël të furnizimit me pajisje zyre të llojeve të ndryshme, si tavolina qelqi,piktura,tapete,perde,etj .Fondi i alokuar nën projektin M89001 ka qenë 520 në mijë leke dhe realizuar në masën 501 në mijë leke.
- Ndjekur afatet dhe procedurat për shlyerjen e garancisë së punimeve 5% ,gjatë zbatimit dhe përfundimit të rikonstruksionit të zyrave fituar nga firma Prim Konstruksion në vitin 2010.Fondi i alokuar nga Ministria e Financave ka qenë në shumen 52 në mijë leke dhe realizuar në masën 52 në mijë leke.

**II- Fondi per shpenzim Operative (zeri 602) , nga vlera e pergjithshme prej 8.149 (ne mije leke) per periudhen e raportuar, eshte prokuruar dhe realizuar ne masen 7.966. ne mije leke ose 98 % e fondit te planifikuar vjetor. duke respektuar kerkesat e detajuara ne Regjistrin e Prokurimeve Publike, te miratuara edhe nga Agjensia e Prokurimeve Publike.**

Regjistri i prokurimeve , me ndryshimet, eshte realizuar ne permbushje te objektivave dhe strategjise se miratuar per komisionerin per Mbrojtjen e te Dhenave personale per vitin 2011. e ndare ne produktet qe do te realohen me fondet e alokuara nga ministria e Fianacave e konkretisht

Ne realizimin e shpenzimeve operative , Komisioneri, eshte mbeshtetur ne nje shperndarje sa me racionale te kerkesave duke patur parasysh dhe objektivat dhe produktete per cdo Drejtori te cilat lidhen me :

- o Realizimin e shpenzimeve te pergjithshme dhe shlyrtjes se detyrimeve me shtetin , si detyrime energji elektrike, uje ,shrbime postare , shpenzime telefonike per stafin, ne funksion ten je verpimtarie normale institucionale e cila ze nje peshe relaitivisht te madhe ne perdorimin e fondve totale. Shuma e likujduuar per kete ze, duke mos perfshire detyrimet e muajit dhjetor 2011 eshte ne maen 1674.510 leke . detyrimet e prapambeture te cilat do te likujdohen me fondet e vitit 2012 jane rreth shumes 130.000 leke
- o Realizimi I shpenzimeve te prokurimit me procedure Blerje e vogel me object “ruajtje e sigurim objekti” realizuar ne masen 463.680 leke me firmen Ales shpk
- o Realizimi I blerjeve te mallrave te natyrave te ndryshme te cilat jane prokuruar me procedure e blerjeve te vogla ,si kanceleri,toner,material pastrami e ndricimi, te tjera te pergjithshme ne Shumen 1403.682 leke
- o Realizuar mbeshtetja financiare per aktivietet e organizuara Brenda e jashte vendit, si konferenca e takoime nderkombetare, vizita te stafit per shkambi experience dhe lidhje mareveshje bashjkepunimi ne Shumen 2.241.477 leke .
- o Ndjekur dhe realizuar proceduira me Objekt “Abonimi ne shtypin vendas dhe te huaj “ si dhe blerje te librave profesionale ,kode per perdorim te brendshme ,ne s273.600, me procedure Blerje e vogel prane Agjencise se abonimeve te Shtypi “
- o Ndjekur dhe realizuar procedurat per shpenzimet e transportit ,karburant,pjese kembimi, riparimi dhe siguracione ne Shumen 414.970 leke
- o Ndjekur dhe realizuar shpenzimet te mirembajtjes me procedure blerje e vogel, per godinen dhe aparaturat teknike ne Shumen prej 502790 leke.

- o Ndjekur dghe realizuarshpenzime te tjera te ndrushme si pritje e percjellje , sherrbbime te mirembajjes se programe financiare, sherbime perkthimi dhe organiozimi te aktivietetve me karakter social kulturor ne masen 272075 leke

Per virin 2012 ne lidhje me performancen financiare do te mundohemi te parashikojme me drejt , me sakte, te gjitha nevojat ne permbushje te objektivave strategjike, operacionale dhe te detajuar per cdo drejtori sipas prioriteteve , per nje perdorim me sa me eefektiviet, ekonomi dhe eficense te fondeve buxhetore brenda kuadrit ligjor .

Konc:L.Xhakaj,  
Sigloi: L.Morina

